



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së parë inauguruese të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur me 23. 12. 2013 në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

- | | |
|--------------------------|--------|
| 1. Florent Hoxha | anëtar |
| 2. Petrit Kelmendi, | anëtar |
| 3. Ragip Zejnullanu, | anëtar |
| 4. Nazmi Krasniqi, | anëtar |
| 5. Enver Kozhani, | anëtar |
| 6. Feriz Hasani, | anëtar |
| 7. Ali Stublla, | anëtar |
| 8. Valbona Shillova, | anëtar |
| 9. Burbuqe Ilazi, | anëtar |
| 10. Shqipe Rexhepi, | anëtar |
| 11. Labinot Shahini, | anëtar |
| 12. Adrian Rashiti, | anëtar |
| 13. Daut Azemi, | anëtar |
| 14. Agron Hajdini, | anëtar |
| 15. Arton Retkoceri, | anëtar |
| 16. Naim Jahiri, | anëtar |
| 17. Vlora Limani-Hajnuni | anëtar |
| 18. Burbuqe Fazliu, | anëtar |
| 19. Linda Shahini, | anëtar |
| 20. Xhevat Olluri, | anëtar |
| 21. Heset Sahiti, | anëtar |
| 22. Enver Bikliqi, | anëtar |
| 23. Mevlide Shamolli, | anëtar |
| 24. Hajrije Salihu, | anëtar |
| 25. Arben Bahtiri, | anëtar |
| 26. Edita Gashi, | anëtar |
| 27. Blerim Gashi, | anëtar |
| 28. Albulena Gashi, | anëtar |
| 29. Xhavit Maholli, | anëtar |
| 30. Naser Bytyqi, | anëtar |
| 31. Zoran Çirković, | anëtar |

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Fitim Selimi, Nënkyetar i Komunës
3. Sefer Tasholli, Nënkyetar i Komunës
4. Sanije Haziri, përfaqësuese e OSBE-së
5. Kimete Jashanica, përfaqësuese e OSBE-së
6. Përfaqësuesit e MAPL-së
7. Përfaqësuesit e KFOR-it
8. Bekim Krasniqi, OJQ"YAHK"
9. Halim Haliti, OJQ" BALLKAN"
10. Përfaqësuesit e medijave
11. Naser Bytyqi- përkthyes, shqip-serbisht
12. Haki Avdiu, Operator për zërim dhe inqizim të mbledhjes

Proqesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Sami Murati**.

Mbledhjen e kryesoi anëtarja më e vjetër e Kuvendit Hajrije Salihu e cila fillimisht përshëndeti të pranishmit dhe në vazhdim tha se ndihem mirë për rastin që sot kryesoj këtë mbledhje inauguruese të Kuvendit ku shumica e anëtarëve të këtij Kuvendi ishin nxënës të mi dhe se çdo herë ky Kuvend po përtrihet me anëtarë të rinjë dhe kjo mbledhje inauguruese është e veçantë nga mbledhjet tjera me që po bëhen ndryshime që janë më së të nevojshme.

Pastaj tha se për këtë mbledhje e keni marr rendin e ditës, andaj pyes se kush është për aprovimin e rendit të ditës.

Pas votimit konstatoi se Kuvendi unanimisht për punën e kësaj mbledhje aprovoi këtë:

REND DITE

1. Dhënja e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës
2. Dhenja e betimit të Kryetarit të Komunës
3. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës
4. Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Komunës

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Dhënja e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e mbledhjes Hajrije Salihu ftoj anëtarët e zgjedhur të Kuvendit që të ngritën në këmbë dhe të bëjnë betimin duke lexuar deklaratën solemne.

Pastaj anëtarët e Kuvendit duke lexuar deklaratën solemne dhan betimin.

Shtesë: Deklaratat solemne.

II

Dhënja e betimit të Kryetarit të Komunës

Lidhur me këtë pikë anëtarja më e vjetër e Kuvendit, Kryesuese e mbledhjes, ftoi Kryetarin e Komunës z. Imri Ahmetin i cili dha betimin para Kuvendit duke lexur deklaratën solemne.

Pastaj Kryesuesja kërkoi nga Kryetari që të paraqet fjalën përshëndetëse.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës paraqiti fjalën përshëndetëse duke shtuar se normalisht unë ndjej një kënaqësi të veçantë, qytetarët e nderuar të Lipjanit dhe me këtë rast më lejoni të përgëzoj të gjithë këshillëtarët e zgjedhur dhe përshëndes të gjithë juve dhe institucionet e komunës. Për neve kjo paraqet një përgjegjësi të veçantë, një përgjegjësi që jam shumë i bindur se do ta bartim përgjegjëshëm para qytetarëve të Lipjanit. Ne jemi zgjedhur për të qeveris në mënyrë të drejtë të ndershme dhe të përgjegjëshme, ne jemi zgjedhur për të shërbyer e jo për të rrëmbyer, ne jemi zgjedhur për ta qar vendin përpara në progres e jo në regres, ne jemi zgjedhur për të zhvilluar demokracinë e jo autokracinë dhe unë jam shumë i bindur se bashkë me kolegët e mi do t'i arrijmë që qytetarëve të Lipjanit tu ofrojmë një qeverisje të ndershme. Të jeni të bindur se në qeverisjen tonë do të ketë nderë dhe përgjegjësi, llogaridhënie, transparencë dhe ata njerz që kanë keq menagju nuk do të kenë vend këtu. Me këtë rast dua të falenderoj të gjitha strukturat e gjertanishme të pushtetit komunal për punët e mira që kanë bërë. Në fund uroj qytetarët e Lipjanit për një qeverisje të re, urime.

Shtesë: Deklarata solemne.

III

Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës

Lidhur me këtë pikë anëtarja më e vjetër e Kuvendit Hajrije Salihu, njoftoi Kuvendin që së pari duhet të formojmë komisionin zgjedhor dhe komisionin verifikues.

Pas propozimeve të anëtarëve të Kuvendit për anëtarë të komisionit zgjedhor dhe komisionit verifikues si dhe pas votimit për anëtarë të komisioneve Kryesuesja konstatoi se për: Komisionin zgjedhor u zgjodhen

1. Daut Azemi
2. Xhavit Maholli dhe
3. Naser Bytyqi

Për komisionin verifikues u zgjodhën:

1. Labinot Shahini
2. Enver Bikliqi dhe
3. Edita Gashi

Pas zgjedhjes së komisionit zgjedhor dhe komisionit verifikues Kryesuesja kërkoi që të propozohen kandidatët për Kryesues të Kuvendit.

Adrian Rashiti propozoi Vlora Limani-Hajnuni për Kryesuese të Kuvendit.

Pasi propozime tjera nuk pati Kryesuesja e mbledhjes Hajrije Salihu kërkoi nga komisioni zgjedhor që të përgadit fletë votime.

Pas përgaditjes së fletë votimeve u kalua në votim duke ftuar me emër anëtarët e Kuvendit.

Pas përmbylljes së votimit, Kryesuesja kërkoi nga komisioni verifikues që të verifikon rezultatin e votimit.

Pas numrimit të votave, Kryetari i komisionit verifikues njoftoi Kuvendin se nga 31 fletë votime 21 vota janë për kurse 10 fletë votime janë të pa vlefshme. Dhe në bazë të këtij rezultati u konstatua se për kryesuese të Kuvendit u zgjodh Vlora Limani-Hajnuni.

Pastaj Kryesuesja e mbledhjes Hajrije Salihu ftoi Kryesusen e posazgjedhur të Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni që të merr vendin dhe të udhëheq mbledhjen.

Pastaj Vlora Limani-Hajnuni fillimisht falenderoi anëtarët e Kuvendit për besimin e dhënë dhe shtoi se mbrenda këtij mandati do të punojmë për të mirën e qytetarëve.

Në vazhdim fjalën i dha Kryetarit të Komunës z. Imri Ahmetit i cili në vazhdim falenderoi anëtarët e Kuvendit për besimin e dhënë për zgjedhjen e Kryesueses të cilës i uroj përzgjedhjen për Kryesuese të Kuvendit duke thënë se mendoj se është një përzgjedhje e mirë dhe ndiej knaqësi të veçantë që LDK-ja i ka dhënë rëndësi të veçantë çështjes së barazisë gjinore.

Në vazhdim njoftoi Kuvendin se bazuar në ligjet në fuqi si dhe në kopetencat të cilat i ipen Kryetarit të Komunës unë bëjë publike kabinetin tim me të cilin mendoj që nga sot të filloj punën:

- Nënkryetari i parë, Fitim Selimi,
- Nënkryetarë i dytë, Sefer Tasholli,

Për Drejtor janë emëruar:

1. Rasim Hasani, Drejtor i DKA-së
2. Avdullah Fazliu, Drejtor i DSHMS-së
3. Latif Ramadani, Drejtor i DEZH
4. Ilir Tasholli, Drejtor i DPU-së
5. Adem Duriqi, Drejtor i Prokurimit
6. Heset Sahiti, Drejtor i DSHP-së
7. Imer Rustemi, Drejtor i DI
8. Remzi Mehmeti, Drejtor i DMSH-së
9. Avni Olluri, Drejtor i DGJK-së
10. Shkelzen Hajdini, Drejtor i DBF-së
11. Basri Hashani, Drejtor i DKRS dhe
12. Feti Krasniqi, Drejtor i DBPZHR

Pasi çështje të tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 10,⁴⁵

***Ekstraktin e hartoi
Sami Murati***

***Anëtarja më e vjetër e Kuvendit
Hajrije Salih***

***Kryesuesja e Kuvendit
Vlora Limani- Hajnuni***